

Kushtetuta Neni 77

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë
("Gazeta zyrtare e RM"-së nr. 52/91) – ekstrakt

Paragrafi 1 i nenit 77 është zëvendësuar me pikën 1 të Amendamentit XI, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni është plotësuar me pikën 2 të të njëjtit amendament ("Gazeta zyrtare e RM"-së nr. 91/01)

Neni 77

Kuvendi zgjedh Avokatin e Popullit.

Avokati i Popullit i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve, kur ato u cenohen nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet e organizatat e tjera që kanë autorizime publike.

Avokati i Popullit zgjedhet me kohëzgjatje prej tetë vjetësh me të drejtë edhe për një zgjedhje.

Kushtet për zgjedhje dhe shkarkim, për kompetencën dhe për mënyrën e punës së Avokatit të Popullit rregullohen me ligj.

Amendamenti XI

1. Kuvendi zgjedh Avokatin e Popullit me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, gjatë votimit duhet patjetër të ketë edhe shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, të cilët u përkasin bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.
2. Avokati i Popullit i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të cilëve ato u janë cenuar nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet e organizatat që kanë autorizime publike. Avokati i Popullit kujdes të veçantë i kushton mbrojtjes së parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të bashkësive në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësisive të administratës lokale dhe në institucionet dhe shërbimet e tjera publike.
3. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 1 i nenit 77, ndërsa me pikën 2, plotësohet paragrafi 2 i nenit 77 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

Amendamenti XII – ekstrakt

1. Kuvendi themelon Komitetin për marrëdhënie ndërmjet bashkësive.

Komiteti përbëhet nga 19 anëtarë, prej të cilëve nga shtatë anëtarë prej radhëve të deputetëve të Kuvendit, maqedonas dhe shqiptarë, ndërsa nga një anëtar prej radhëve të deputetëve: turq, vllah, romë, serb dhe boshnjakë. Nëse ndonjëra nga bashkësitë nuk ka deputetë, Avokati i Popullit, pas konsultimeve me përfaqësues relevant të atyre bashkësive, do t'i propozojë anëtarët e tjerë të Komitetit.